

AFRIM KRASNIQI**BYROJA POLITIKE NË PLURALIZËM, VENDIMMARRJET
DHE AKTIVITETI GJATË PERIUdhËS DHJETOR 1990 –
QERSHOR 1991**

Në Statutin e PPSH të vitit 1948, Byroja Politike e Komitetit Qendror rezultonte si organi më i lartë përgjegjës “*për punën politike dhe për udhëheqjen e përgjithshme të punës organizative të KQ*”¹. Ky përcaktim i shkurtër ishte i mjaftueshëm për ta shndërruar Byronë Politike në strukturën më të lartë drejtuese të PPSH dhe të shtetit, si dhe në organin kryesor vendimmarrës dhe udhëheqës. Institucioni i Byrosë ekzistoi që në fillimet e PKSH/PPSH, por u rrit deri në njësim me shtetin gjatë dekadës së parë të periudhës së vendosjes së sistemit njëpartiak. Roli i Byrosë Politike u forcua ndjeshëm sidomos gjatë viteve `50, pas ndryshimeve kushtetuese, kur drejtuesi kryesor i PPSH-së, Enver Hoxha hoqi dorë nga posti i kryeministrit dhe funksionet e tjera ekzekutive duke mbajtur vetëm funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm e më pas, të Sekretarit të Parë të KQ të PPSH.

Pas këtij ndryshimi, vetë Hoxha, si dhe dy strukturat e propozuara prej tij, Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ, ishin realisht struktura drejtuese të shtetit. Organet e tjera kushtetuese dhe shtetërore, përfshirë Këshilli i Ministrave, Kuvendi Popullor apo Presidiumi i Kuvendit Popullor nuk kishin rol në vendimmarrjet e rëndësishme partiake dhe politike. Secila prej tyre, përfshirë edhe organet e hetimit, organet gjyqësore dhe administrative, Komitetet Ekzekutive dhe pushteti popullor, drejtuesit e institucioneve të sigurisë, të mbrojtjes, të diplomacisë etj., të gjithë ishin struktura varësie nga Byroja dhe Sekretari i Parë i KQ. Në praktikën legjislativë, çdo vendim politik merrej fillimisht në Byronë Politike dhe më pas në formë urdhri, vendimi apo direktive, kalonte si akt i detyrueshëm për zbatim nga organet e tjerë, përfshirë edhe institucionet që kishin natyrë teknike apo profesionale. Për dekada, vendimet e Byrosë kishin më shumë vlerë sesa vetë nenet e

¹ *Dokumente kryesore të PPSH (1949-1956)*, vëll. II, botim i Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, Tiranë: 8 Nëntori, 1971. Statusi i PPSH, 18 nëntor 1948, f. 529.

Kushtetutës së vitit 1946 apo 1976. Fakti se edhe akte me rëndësi, si ndalimi i besimeve fetare, vendosja e aleancave ndërkombëtare, hyrja dhe dalja nga Traktati i Varshavës etj., nuk u bënë në Kuvend, siç përcaktohej nga Kushtetuta, apo listat e personave për pushkatim më 1951 apo në shumë raste të tjera, nuk u morën nga organet e drejtësisë por u përcaktuan nga Byroja, - janë tregues të mbipushtetit të saj dhe rolit formal të institucioneve të tjera.

Anëtarësia në Byro ishte promovimi më i lartë, karriera më kulmore dhe privilegji më i madh në sistemin njëpartiak. Byroja Politike përbëhej nga 8-12 anëtarë, fotot e të cilëve ishin të vendosura në çdo shkollë dhe ndërtesë kulturore e publike. Anëtarët e Byrosë banonin në zonën me trajtim e mbrojtje të veçantë, të njohur si zona e Bllokut në Tiranë, ata qëndronin në podiumet e nderit në manifestimet vjetore publike dhe fotot e tyre mbaheshin nga punëtorë, të rinj, ushtarakë e pjesëmarrës të tjerë në parakalimet e mitingjet e mëdha vjetore.

Midis burimeve të shumta që konfirmojnë mbipushtetin e Byrosë Politike bën pjesë edhe deklarata në parlamentin e vitit 1991 e ministrit të Tregtisë së Jashtme, gjatë qeverisë së fundit komuniste, Shane Korbeci. Gjatë fjalës së tij në parlament me rastin e heqjes së imunitetit, më 1991, ai deklaroi se *“në diktaturë kishte dy qeveri: Këshilli i Ministrave dhe Byroja Politike, ndaj së cilës Këshilli i Ministrave nënshtrohej në mënyrë absolute. Vendimet e Byrosë Politike ishin ligj, tabu, siç ishte ligj edhe fjala e çdo anëtari të Byrosë Politike. Unë vërtetë isha ministër, por organizmat e tjera e sidomos drejtorët e Drejtorisë së Pritjes ishin më shumë se ministra për funksionet e tyre. Secili nga ne që jemi sot në këtë parlament, e di mirë se ç’do të pësonte cilido që do të guxonte të bënte qoftë dhe aluzionin më të vogël ndaj shpërdorimit dhe privilegjeve të ligjëruara me dispozita të veçanta nga Byroja Politike për anëtarët e saj”².*

Kjo trashëgimi dhe ky pushtet i Byrosë Politike do të duhej të mbyllej së paku më 17 dhjetor 1990, ditën kur zyrtarisht Shqipëria miratoi sistemin shumëpartiak. Atë ditë, Presidiumi i Kuvendit Popullor nxori dekretin *“për krijimin e organizatave e shoqatave politike”*³, akt që ligjërisht i jep fund sistemit njëpartiak në Shqipëri dhe shënon fillimin e

² Kuvendi i Shqipërisë, *Punime të Kuvendit. Viti 1991, Legjislatura e 12-të*, f. 2231.

³ Dekret 7442, datë 17 dhjetor 1990, *“Për krijimin e organizatave e shoqatave politike”*, në *Fletore Zyrtare*, nr.9, Tiranë: 1990.

pluralizmit politik. Sipas neni 1 të dekretit “*në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, në bazë të nenit 54, të Kushtetutës, shtetasve u njihet e drejta të formojnë organizata (parti) ose shoqata politike e shoqërore*“. Dekreti pasoi vendimin e datës 11 dhjetor 1990 të Byrosë Politike dhe të Plenumit të XIII Komitetit Qendror të PPSH-së, sipas pikës 5 të të cilit, “*Plenumi i KQ të PPSH-së shprehu mendimin se është në dobi të demokratizimit të mëtejshëm të jetës së vendit dhe të pluralizmit, krijimi i organizatave politike të pavarura në përputhje me ligjet në fuqi*”. Me lejimin e pluralizmit dhe krijimin e partisë së parë politike opozitare, dekreti përfaqësonte aktin formal të legalizimit të zhvillimeve në terren, të imponuara nga lëvizja e studentëve të Universitetit të Tiranës.

Analiza e dokumenteve arkivore dhe akteve zyrtare të periudhës së dhjetorit 1990 dhe muajve pasues të pranverës së vitit 1991, tregojnë se as pas vendosjes së pluralizmit dhe hyrjes së vendit në një sistem të ri politik, roli i Byrosë Politike nuk u cenua. Vetë akti për pluralizmin erdhi nga debati dhe vendimi në Byronë Politike, pra në organin më të lartë politik të partisë-shtet, dhe jo në Kuvendin Popullor apo në institucionet me natyrë shtetërore. Ky është një prej tipareve dalluese të Shqipërisë në raport me përvojat e ndryshimit në vendet e tjera ish komuniste. Akti ishte edhe një konfirmim tjetër i faktit se në sistemin njëpartiak partia ishte forca kryesore udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë dhe se roli i institucioneve kushtetuese ishte dytësor në raport me pushtetin absolut të PPSH. Kushtetuta e RPSSH, e cila identifikohet si një model i ashpër i partisë shtet, mbeti në fuqi deri në prill 1991, pra, rreth pesë muaj pas miratimit të pluralizmit politik dhe ndryshimit të sistemit politik.

Bilanci i mbledhjeve të Byrosë Politike në sistemin pluralist

Lejimi i pluralizmit politik dhe nisja e proceseve të transformimeve drejt një shoqërie pluraliste konkurruese pritej të shoqërohej me ndryshime thelbësore në rolin e PPSH në shtet dhe shoqëri dhe bashkë me të, edhe rolin e organit më të lartë drejtues, Byrosë Politike. Në mesin e dhjetorit 1990, Byroja Politike ligjërisht nuk ishte më një strukturë shtetërore drejtuese, por një strukturë e një partie politike, PPSH, ndërkohë që në vend u krijuan parti të reja konkurruese, përfshirë PD, PR, PE etj. Lejimi i pluralizmit politik zyrtarisht e zhvlerësoi rolin dhe

funksionin e saj udhëheqës në shtet dhe në shoqëri. Megjithatë, analiza e detajuar e ngjarjeve politike të periudhës pas dekretit të 17 dhjetorit dhe deri në mesin e qershorit 1991 tregojnë se Byroja Politike, ndryshe nga statusi ligjor dhe politik i papajtuësëm me rrethanat e reja, vijoi të ishte funksionale dhe të kishte rol vendimmarrës e drejtues në strukturën shtetërore.

Gjatë periudhës në analizë, pas 8 dhjetorit 1990 deri më 10 qershor 1991, Byroja Politike zhvilloi edhe të paktën tetë mbledhje të rregullta. Mbledhja e parë i përket momentit të diskutimit dhe të miratimit të kërkesave të studentëve për pluralizmin politik. Mbledhja e dytë zhvillohet në ditët e daljes së dekretit për pluralizmin me fokus kryesor debatin për situatën e re politike dhe vendimin për heqjen e busteve ndërtuese të Stalinit në Shqipëri. Dy mbledhje të tjera u zhvilluan gjatë javës së fundit të muajit dhjetor 1990, secila në lidhje me programin politik të PPSH, nismën për hartimin e një Kushtetute të re, si dhe miratimin e listës së kandidatëve të PPSH për zgjedhjet e dekretuara për datën 10 shkurt 1991. Mbledhja e radhës u zhvillua në mesin e janarit 1991 me fokus analizën politike dhe vendimin për miratimin e kërkesës së opozitës për shtyrjen e zgjedhjeve parlamentare. Në fundin e muajit shkurt zhvillohet një mbledhje e përbashkët e Byrosë dhe e Këshillit Presidential pas ngjarjeve që çuan në rrëzimin e bustit të Hoxhës, në mars dhe në prill vijon të ketë mbledhje të tjera të Byrosë kryesisht në përgjigje të zhvillimeve politike në vend dhe në përpjekjet e PPSH për t'iu përshtatur sistemit të ri, në maj ka vetëm një mbledhje dhe në qershor Kongresi i PPSH vendosi shkarkimin e Byrosë Politike dhe heqjen e saj si strukturë nga dokumentet zyrtare të Partisë Socialiste, e cila doli nga ky kongres.

Analiza e rendit të ditës dhe vendimmarrjeve të mbledhjeve të Byrosë Politike në këtë periudhë të jetës pluraliste, ndihmon për të kuptuar më mirë paradoksin e madh, - bashkëjetesën dhe varësinë e shtetit të ri pluralist dhe demokratik me organin kryesor vendimmarrës të periudhës komuniste, Byronë Politike. Mbledhja e parë i përket momentit të lejimit të pluralizmit në dhjetor 1990. Sipas materialeve të kësaj mbledhjeje⁴ publikuar nga studiuesi Aleksandër Meksi, fokusi kryesor lidhej me aktualitetin politik dhe kërkesën e studentëve për pluralizmin politik. Mbledhja është bërë disa orë përpara takimit të përfaqësisë së

⁴ Aleksandër Meksi, *Dhjetor 90, Dokumente e Materiale*, Tiranë: UET Press, f. 12-26.

studentëve me Ramiz Alinë, kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Sekretar i Parë i KQ të PPSH, si dhe vendimit të Plenumit XIII për lejimin e pluralizmit politik. Në mbledhje, Alia, informon për protestat e studentëve, për përmbajtjen e detajuar të peticionit me kërkesat e tyre, për përpjekjet e tij për bisedime dhe gjendjen e rënduar në të cilën ndodhet regjimi për shkak të presionit në rritje ndaj tij. Alia thotë se ka vetëm dy alternativa “*ose të ndërhysh t’i shpërndash ose të përdorësh armët*”. Ai vlerëson se kërkesa e studentëve për dialog me të në Qytetin “Studenti” është “*kërkesë për të më eliminuar dhe diskretituar mua*”. Ai mbështet variantin e parë, por analizon edhe variantin e përdorimit të armëve, duke paralajmëruar se “*vetëm varrimi i atyre që do të masakrosh do të shndërrohet në një manifestim tjetër të madh që në asnjë mënyrë nuk e përballon dot*”⁵.

Gjatë takimit diskutohet gjerësisht nëse do të lejohet kërkesa e studentëve për të krijuar një parti të re politike dhe nëse do lejohet pluralizmi politik. Shumica absolute e anëtarëve të Byrosë janë në favor të përpjekjeve për të mos lejuar pluralizmin politik, por për të mbajtur një qëndrim më liberal ndaj një grupi të mundshëm studentësh si subjekt zgjedhor. Një prej tyre, Foto Çami, duke u shprehur se “*po të jetë për ne, nuk jemi dakord të ketë pluripartizëm, por puna është që je i detyruar ta bësh se ta diktojnë të tjerët*” pasqyron më mirë presionin që vjen nga lëvizja studentore dhe qëndrimin refuzues të vetë Byrosë ndaj nevojës për hapje drejt pluralizmit politik. Në mbledhje diskutohet gjerësisht edhe nëse do të ketë Byro Politike, nëse do të ketë ndryshime të disa anëtarëve të saj apo të të gjithë strukturës. Vendimi final u mor në mbledhjen vijuese në Komitetin Qendror, ku u vendos lejimi i pluralizmit politik dhe u shkarkuan nga Byroja Politike pesë anëtarë dhe dy kandidatë të Byrosë Politike.

Në Arkivin Qendror të Shtetit gjendet edhe një dokument zyrtar për mbajtjen e mbledhjes së Byrosë Politike më 21 dhjetor 1990. Materiali nuk është zbardhur asnjëherë dhe në Arkiv nuk janë depozituar materiale të mbledhjes, me përjashtim të njoftimit për mbledhjen dhe njoftimit se zhvillimi i saj është i regjistruar në audio. Materiali në audio është gati i pamundur të verifikohet sipas diskutantëve. Pas mbledhjes së Byrosë

⁵ *Po aty.*

Politike u bë publik njoftimi⁶ se “*me propozimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe duke marrë parasysh se kanë ndryshuar kushtet historike, kur në vendin tonë u morën vendime lidhur me nderimin e J.V.Stalinit, Këshilli i Ministrave të RPSSH vendosi: të hiqet emri i J.V.Stalinit dhe simbolet e tij nga ato ndërmarrje, objekte dhe institucione shtetërore që mbajnë këtë emër*”. Në vijim të vendimit theksohej se “*për kooperativat bujqësore dhe qendrat e banuara që mbajnë emrin e J.V.Stalinit, të vendosin banorët e tyre sipas ligjeve në fuqi*”.

Një mbledhje tjetër e Byrosë Politike u zhvillua më 24 dhjetor 1990. Mbledhja pati si rend dite diskutimin e programit politik të PPSH për fushatën elektorale, miratimin e kandidatëve për deputetë si dhe një ndryshim procedural lidhur me kriteret e zgjedhjes dhe emërimit të kuadrove në parti. Në Arkivin Qendror të Shtetit kjo mbledhje, gjithashtu nuk ka dokumentacion shoqëruar të detajuar, me përjashtim të një kopje të tri akteve të diskutuara dhe miratuara, si dhe njoftimit mbi përmbajtjen e axhendës. Një mbledhje tjetër e Byrosë Politike u zhvillua brenda të njëjtës javë, më 30.12.1990. Fokusi kryesor i kësaj mbledhjeje ishte miratimi final i programit politik të PPSH për fushatën elektorale, pas sugjerimeve dhe vërejtjeve të bëra në arkivin kombëtar të 26 dhjetorit.

Mbledhja e fundit e dhjetorit 1990 ka vlerë të veçantë në raport me Byronë Politike, pasi diskutohet mbi kandidimin ose jo të vetë anëtarëve të Byrosë në zgjedhjet e para shumëpartiake të vitit 1991. Në përfundim të mbledhjes, në listën e kandidatëve u përfshinë 11 anëtarë ose kandidatë të Byrosë Politike, përfshirë Alia dhe Çarçani, dy figurat kryesore drejtuese të regjimit. Megjithatë lista u shpall në kushtet e pluralizmit politik kur shteti dhe PPSH nuk mund të ishin më të njësuara, në listë bënë pjesë edhe 12 ushtarakë të lartë përfshirë drejtuesit kryesorë të Ushtrisë, drejtuesit kryesorë të duhej të ishin organe të pavarura dhe pushtete të ndara nga PPSH. Pjesë e listës ishin edhe 11 kryetarë të Komiteteve Ekzekutive, 45 drejtorë ndërmarrjesh të rëndësishme shtetërore dhe 31 kryetarë kooperativash. Në listë ishin edhe tre diplomatë, disa anëtarë të Hetuesisë së Përgjithshme, të Gjykatës së Lartë dhe të organeve të tjera etj., ndërkohë që statistikisht nga sektori

⁶ Vendim i Këshillit të Ministrave, 21 dhjetor 1990, “Për heqjen e bustit dhe emrin e Stalinit”, në *Fletore Zyrtare* nr. 9, Tiranë: 1990.

dominues ishte ai bujqësor me 71 kandidatë, inxhinieria me 61 kandidatë, si dhe në fund, vetëm 9 kandidatë me diplomë në drejtësi⁷.

Përfshirja e anëtarëve të Byrosë në listat e kandidatëve është tregues i pozitës së fortë të Byrosë në vendimmarrjet e PPSH edhe në kushtet e pluralizmit, por edhe e pafuqisë së saj për të kuptuar si duhet zhvillimet e reja politike në vend dhe për të hyrë në rrugën e reformimit të thellë. Përfshirja e drejtuesve ushtarakë, diplomatë apo të sektorit të drejtësisë, vjen si zgjatim i modelit të njëjtë të aplikuar nga PPSH gjatë sistemit njëpartiak, tashmë edhe në kushtet e pluralizmit politik.

Një prej mbledhjeve me rëndësi të Byrosë Politike në memorien shtetërore dhe politike të fillimeve të tranzicionit është ajo e datës 10-11 janar 1991. Ajo është nga të paktat mbledhje që kanë vijuar më shumë se një ditë, kryesisht për shkak të konfuzionit në debatin rreth zhvillimeve politike në kushtet e reja të sistemit shumëpartiak. Mbledhja u bë rreth një muaj pas lejimit të pluralizmit dhe një muaj përpara datës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Mbledhja e janarit kishte si temë kryesore analizën e situatës së re politike në vend si dhe shqyrtimin e kërkesës së opozitës për shtyrjen e zgjedhjeve parlamentare të shpallura në kushtet e sistemit njëpartiak më 1 dhjetor 1990. Me dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor data e zgjedhjeve parlamentare ishte caktuar 10 shkurt 1991. Dekreti doli më shumë se dy javë përpara se të lejohej pluralizmi politik dhe të krijoheshin partitë e reja politike. Në rrethanat e krijuara, sfida e parë e opozitës ishte shtyrja e zgjedhjeve parlamentare, në mënyrë që të fitonte kohën minimale për të pasur mundësi për të konkurruar në zgjedhje.

Mbledhja ofron material të pasur për të analizuar integritetin, rolin, natyrën dhe cilësinë e Byrosë Politike në përbërjen dhe kapacitetet e saj. Nga diskutimet del më e qartë teza se Byroja Politike e vlerësonte pluralizmin jo si ndryshim politik për vendin, por si vijueshmëri të qeverisjes në formë më të zbutur. Në 67 faqet e daktilografuara të mbledhjes ata shfaqin dyzimin rreth pluralizmit politik, pafuqinë për analiza objektive si dhe përpjekjet e disa anëtarëve të saj për t'iu larguar përgjegjësive dhe angazhimeve politike në fushatë elektorale.

⁷ Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/AP-org.udh., viti (më tej: V.) 1990, dosja (më tej: D.) 21, fl. 53-54. Miratimi i kandidatëve të partisë për deputetë të Kuvendit Popullor.

Debati mund të ndahet në dy faza. Në fazën e parë anëtarët e Byrosë reflektojnë presionin e frikën në të cilat ndodhen për shkak të presionit të opozitës brenda vendit dhe presionit ndërkombëtar për zgjedhje konkurruese. Në raportin e tij⁸ Alia thekson se më 8 janar 1991 si Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor u takua me një përfaqësi politike të opozitës, e cila kërkoi ndryshimin e ligjit dhe të datës së zgjedhjeve. Argumenti kryesor i opozitës lidhej me faktin se ligji ishte hartuar përpara lejimit të pluralizmit politik dhe e ndan PPSH efektivisht në pesë-pjesë, *“duke i dhënë mundësi asaj që të paraqitet me pesë kandidatë”* përmes organizatave të masave si subjekte elektorale. Kërkesa e dytë e PD-së ishte shtyrja e zgjedhjeve tre muaj, me argumentin se opozita nuk kishte kohë për organizim e konkurrim dhe se nuk ishte në kushte të barabarta me PPSH nga pikëpamja materiale dhe e mundësive efektive të propagandës. Qëndrimi i Alisë ndaj dy kërkesave të opozitës ishte refuzues. *“Zgjedhjet duhet të bëhen sa më shpejt, në mënyrë që të krijohet një stabilitet politik në vend, gjë që do të inkurajojë dhe marrëdhëniet me botën e jashtme e do të krijohen premisa për t’u marrë seriozisht me çështjet e ekonomisë dhe të zhvillimit të vendit”*⁹ theksoi ai. Në takim, dy palët lëshuan kërcënime ndaj njëra-tjetrës. Opozita e kërcënoi Alinë se nëse nuk bën ndryshime në datën e zgjedhjeve atëherë opozita do t’i bojkotojë ato, duke iu bërë thirrje edhe qytetarëve të mos marrin pjesë. Alia kërcënoi opozitën se po destabilizon vendin dhe iu kërkoi në mënyrë të prerë të mos kritikojnë Enver Hoxhën, me argumentin se *“është shumë sensibil në çështjen e Luftës Nacionalçlirimtare, se ka derdhur gjak për fitoren e saj. Të ofendosh luftën është e palejueshme. Ajo ka pasur një komandant të përgjithshëm, që e ka udhëhequr atë gjatë gjithë kohës së saj, prandaj duhet të kini kujdes në këtë çështje”*¹⁰.

Pavarësisht toneve dhe mosmarrëveshjes në takim, në mbledhjen e Byrosë Politike interpretimi i tij mbi situatën dhe bojkotimin e mundshëm të zgjedhjeve është shumë më i ndryshëm. Në raportimin e tij. Alia thekson se bojkoti i paralajmëruar i opozitës krijon probleme të mëdha politike për vendin dhe raportet e tij ndërkombëtare dhe se, në mbështetje të opozitës janë qendrat kryesore urbane, si Shkodra, Durrësi,

⁸ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh, V. 1991, D. 2. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 06.03.1991, fl. 2.

⁹ *Po aty*, fl. 3.

¹⁰ *Po aty*.

Kavaja, Elbasani, Vlora, Fieri, Lushnja e Korça. Ai shpreh frikën se edhe minatorët e Valiasit dhe grupe të tjera sociale i janë bashkuar kërkesave të opozitës dhe akuzoi anëtarët e Byrosë Politike se nuk lexojnë dhe nuk i kuptojnë ngjarjet e njëjta që janë zhvilluar në vendet e tjera ish komuniste, përfshirë Bullgari e Rumani. Sipas tij, ndryshe nga Rumania, ku minatorët u përdorën për të mposhtur studentët, Alia theksoi se në Shqipëri kjo nuk mund të ndodhë, për shkak se minatorët tanë janë me studentët, jo kundër tyre. Edhe duke iu referuar përvojës bullgare ai paralajmëroi se zgjedhjet pa opozitën do të sillnin protesta masive të opozitës, manifestime dhe greva në sheshet kryesore dhe në bulevardin përpara kryeministrisë, Kuvendit dhe PPSH. Më tej, ai e cilësoi opozitën “armike” në referim me përvojat e vendeve të tjera ish komuniste, në të cilat “*eksperiencia na tregon që armiku synon pushtetin*”¹¹.

Gjatë debatit gjenden të gjithë elementët e skenarëve të mundshëm, nga diskutimet refuzuese për shtyrjen e zgjedhjeve, nga sugjerimi që të lejohet krijimi vetëm i një organizate studentore të jetë subjekt elektoral dhe deri tek propozimi i Sekretarit të KQ, Spiro Dede, sipas të cilit “*neve na intereson që në Kuvendin Popullor të ketë 20-50 deputetë të tyre, se do të jetë mirë dhe për opinionin e jashtëm. Ndryshe do të jetë me pasoja, do të lihet shteg për të bërë sherr dhe destabilizim*”¹². Anëtarë të Byrosë si kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit. Niko Gjyzari ishin kundër shtyrjes, pasi “*shtyrja tregon dobësi për PPSH-në*” dhe propozon që nëse opozita bojkoton atëherë “*organet e rendit, sipas ligjit që kemi, duhet të veprojnë. Ligjet i kemi të plota për mendimin tim, të forcojmë rendin*”. Midis tij dhe kryeministrit Çarçani pati debat nëse qeveria ka kapacitetet për të përmirësuar gjendjen ekonomike, për të arritur në përfundimin se është e pamundur të ketë ndryshime pozitive. Në përfundim, Byroja me vetëm një zë kundër, pranoi parimisht shtyrjen e zgjedhjeve pa përcaktuar një datë fikse, duke përdorur si argument kryesor pikërisht situatën që mund të krijohet në kushtet e refuzimit të opozitës për të marrë pjesë në to.

Faza e dytë e debatit në Byro lidhej me pozitën e re të PPSH dhe të vetë Byrosë ndaj zhvillimeve politike. Byroja i frikësohej presionit që vjen nga anëtarësia dhe akuzave se vetë ajo nuk është në gjendje të marrë

¹¹ AQSH, F. 14/AP-org.udh, V. 1991, D. 2, fl. 4. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 06.03.1991.

¹² Po aty, fl. 6.

vendime që udhëheqin zhvillimet politike. Numri dy i PPSH në linjë partie, Xhelil Gjoni u shpreh se *“të jemi të ndërgjegjshëm që për një kohë shumë të shkurtër janë bërë gjithë këto gjëra dhe kanë tingëlluar sikur këto masa janë marrë nga presioni”* tezë që mbështetet edhe kryeministri Çarçani, sipas të cilit *“kështu janë komentuar, sikur ne jemi tërhequr nga presionet. Dhe në fakt ka një të vërtetë”*¹³. Anëtarët e Byrosë pranojnë se organizatat satelite të saj për rininë, punëtorët, frontin dhe gruan janë fiktive në deklarime dhe se p.sh, shumica e të rinjve janë kundër PPSH, pasi rinia është nëpër mitingje dhe tek ato të PD-së *“nuk ka mbi 35 vjeç”*. Sipas tyre, elita drejtuese të këtyre organizatave kanë humbur lidhjet me realitetin dhe se ka diferenca të mëdha midis deklarimeve të bëra dhe efektit konkret. Byroja harxhoi kohë të gjatë debati mbi arsyetimin që do të përdorej publikisht në vendimin për shtyrjen e zgjedhjeve. Ideja më e mbështetur ishte ajo e Spiro Dedes, sipas të cilit duhet të thuhet se *“në kushtet kur kërkohet një stabilizim i gjendjes dhe njerëzit të punojnë normalisht, për interesat e vendit e për të mirën e demokracisë, ramë dakord që zgjedhjet të shtyhen”*.

Më 6 mars 1991, vetëm 25 ditë përpara zgjedhjeve të para pluraliste, Byroja Politike zhvilloi një tjetër mbledhje të rëndësishme. Fokusi i mbledhjes lidhej me aktualitetin politik dhe mënyrën sesi PPSH duhet të adresohet në fushatën elektorale. Edhe në këtë mbledhje në vend të retorikës për kundërshtarët politikë përdoret termi *“armiqtë”*. Alia thotë në fillim të debatit se *“armiqtë e sulmuan lidhur me rrugën e saj të deritanishme, duke i veshur përgjegjësi dha fajë që nuk i ka, ose duke zmadhuar fajë apo përgjegjësi që në fakt kanë ndodhur”*¹⁴. Më shumë se sulmet politike, Byronë e shqetëson gjendja e rëndë ekonomike dhe çështja se sa kjo problematikë do të kishte ndikime elektorale. Byroja raporton se në vend kishte mbi 30 mijë veta të papunë, 40 mijë paguheshin pa punuar për mungesë të lëndëve të para, duke arritur shifrën më të lartë të papunësisë nën qeverisjen e PPSH në 15%. U raportua se krizës i shtohen edhe elementë të tjerë, si p.sh, mungesa e mallrave në qarkullim, vala e emigracionit, braktisja e fshatit, mbyllja e njësisive të prodhimit etj.

¹³ AQS, F. 14/AP-org.udh, V. 1991, D. 2, fl. 15-1.6. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 06.03.1991.

¹⁴ Po aty, fl. 2. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 06.03.1991.

Një nga elementët me rëndësi në këtë mbledhje është debati mbi rolin e PPSH në shoqëri dhe sidomos në shtet. Në raportin e tij, Alia konfirmon se *“organizmat tonë politikë, si Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes e te tjera kanë pak kontakte me komitetet e Partisë të rretheve dhe shpeshherë, gjenden përpara situatash të vështira. Kur ndodh një gjë, organet e policisë ose të sigurimit të shtetit thonë që ne nuk kemi ç'bëjmë, Partia duhet të punojë. Partia, nga ana e vet, thotë që nuk e kemi ne këtë detyrë, po e ka policia”*¹⁵. Në këtë deklaram duket qartë se në vizionin e Byrosë Politike organet e sigurisë, përfshirë policia, ushtria dhe shërbimi sekret konsideroheshin si organe në funksion të partisë, praktikë e ndjekur përpara vendosjes së sistemit pluralist në Shqipëri. Në vijim të ligjëritit tradicional ai apelon se në rrethana të tilla, *“detyra e parë që shtrohet para Partisë është të ngrihet në këmbë, komunistët të marrin përgjegjësi për çështjen e zhvillimit të vendit, veçanërisht për mobilizimin politik, për luftën kundër elementeve që duan të shkatërrojnë vendin”*.

Mbledhja konfirmon edhe faktin se autoriteti publik i anëtarëve të Byrosë Politike ka pësuar goditje të madhe. Për shembull, në diskutimin e tij, Alia thotë se *“shoku Vangjel Çërrava e thotë hapur që nuk më dëgjon më njeri. Po dhe Xhemal Dymyljen nuk e dëgjon njeri ... Pse nuk e dëgjojnë? Sepse argumentet që kemi ne, janë të tilla që nuk e bindin masën ... shembulli më i mirë ishte me studentët. Vajti t'u fliste sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës, ish-pedagogu i tyre, Ismail Lleshi, djalë me mend, por e fishkëllyen. Kurse po të vejë shoku Llambi Gegprifti besoj se nuk e pranojnë, me gurë e vënë përpara. Ky është realiteti”*. Më tej, ai konfirmon pakënaqësitë në rritje të bazës së partisë ndaj Byrosë kur shprehet se *“siç duket, Partia nuk është e kënaqur me ne. Nga shumë letra që më vijnë nga organizatat bazë partie, nga komunistë, nga shumë takime që kam bërë me mjaft individë dhe me grupe njerëzish, kanë shtruar hapur çështjen që Partia nuk mund të ecë kështu”*. Për herë të parë, Alia pranoi se ka gabuar që nuk ka bërë ndryshime të thella në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror pas ardhjes së tij në krye të PPSH. Ai konfirmoi se *“kur bëme Kongresin e 9-të të Partisë, unë kisha idenë që të ishte kongresi vazhdimësisë, ashtu siç e shpallëm. Këtë vazhdimësi e lidha dhe me njerëzit që ishin në udhëheqjen e Partisë,*

¹⁵ *Po aty*, fl. 4. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 06.03.1991.

domethënë të mos bëheshin ndryshime, se mos dukej sikur me vdekjen e shokut Enver ndryshonim dhe formacionin udhëheqës të Partisë. Në qoftë se në atë kohë kishim mendim pozitiv për këtë çështje, në praktikë vepruam gabim, sepse lamë KQ të Partisë të vjetër, siç ishte, lamë Byronë Politike të vjetër, jo vetëm në kuptimin e njerëzve, po dhe të aftësive sa nuk u përgjigjej kërkesave të kohës. Zhvillimet e mëvonshme e vërtetuan plotësisht këtë”.

Mbledhja e Byrosë Politike më 11 prill 1991 ka në fokus ngjarjet e ndodhura në Shkodër, mënyrën sesi do të organizohet parlamenti i ri pluralist, zgjedhja e drejtuesve të PPSH në grupet dhe komisionet parlamentare, si dhe qëndrimi ndaj sindikatave dhe shoqatave që duan të krijohen. Lidhur me organizimin e punës në Kuvend, Alia deklaroi se “*Byroja Politike do të përcaktojë vijat e përgjithshme të politikës sonë, të cilat shokët që janë në Kuvend do t’i zbatojnë duke i konkretizuar me ligjet, diskutimet etj., që do të ketë Kuvendi*”¹⁶. Aq pak njohuri kishin drejtuesit e shtetit dhe të Byrosë lidhur me jetën parlamentare pluraliste sa më 11 prill, Alia informoi se ka kërkuar nga diplomatët tanë në Bullgari për të mësuar sesi funksionon dhe është organizuar Kuvendi atje në mënyrë që të merret për model edhe në Shqipëri. Ai raportoi me detaje për të gjithë elementët e organizimit dhe më pas u kalua në propozimet nominale mbi individët që do të drejtojnë strukturën e Kuvendit të ri dhe të grupit parlamentar të PPSH. Lidhur me organizatat e ndryshme civile dhe politike, Byroja Politike sugjeroi që “*duhet të mundohemi që t’i kemi nën kontroll ose të ndikojmë mbi partitë, organizatat dhe shoqatat që dalin si kërpudhat*”¹⁷.

Mbledhja e fundit e dokumentuar e Byrosë Politike daton më 15 maj 1991, në të cilën midis të tjerash u diskutua dhe u vendos mbi ecurinë e Shkollës së Partisë, për ndryshime në strukturat organizative të PPSH dhe për problematika të tjera të brendshme.

Reagimet kritike ndaj Byrosë Politike në fillimet e pluralizmit

Pakënaqësitë ndaj Byrosë, përbërjes, rolit dhe funksionit të saj nisën të shfaqeshin në të gjitha nivelet, përfshirë edhe në vetë kupolën e lartë

¹⁶ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 3, fl. 8. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 11.04.1991.

¹⁷ *Po aty*, fl. 6. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 11.04.1991.

drejtuese të PPSH. Në një prej mbledhjeve të Byrosë, në janar 1991 vetë anëtarët e saj pranojnë se privilegjet e anëtarëve të Byrosë kanë ngjallur alergji tek masa qytetare dhe ndaj ka reaksion negativ të qytetarëve ndaj tyre. Citohen raste të strehimit në vila luksoze, të përfitimit të pushtetit për strehimin e njerëzve të afërt të familjes, të dërgimit të fëmijëve jashtë shtetit për studime etj. Në dëshmitë e mëvonshme të vetë anëtarëve të Byrosë pranohet humbja e lidhjes së saj me realitetin gjatë viteve 1990-1991 dhe mbetja jashtë kohës. Për shembull, anëtari i Byrosë dhe Sekretari i KQ, Xhelil Gjoni shprehet mjaft kritik me Byronë dhe kapacitetet e saj. Sipas tij, Byroja Politike ishte e paaftë dhe Alia gaboi kur më 1985 mbajti të njëjtën Byro Politike. Ai thotë se kur erdhi në KQ dhe Byro në mesin e viteve '90, kuptoi se anëtarët e Byrosë nuk kishin asnjë peshë në marrjen e vendimeve dhe se Alia ishte figura dominuese dhe imponuese e çdo vendimi¹⁸. Edhe anëtari i Byrosë dhe kreu i Komisionit të Planit të Shtetit më 1990, Niko Gjyzari konfirmoi se në ngjarjet e periudhës së fundit të sistemit komunist Byroja Politike dhe qeveria ishin shumë të ngurta në marrjen e vendimeve dhe se ishin larg realitetit. Sipas tij, në Byro kishin mbetur shumë njerëz konservatorë, që nuk po kuptonin se çfarë bëhej rreth e rrotull me situatat. Ata akoma diskutonin përparime e norma të trashëguara duke cituar Enverin¹⁹.

Pas ngjarjeve të 18-21 shkurtit 1991, kur edhe greva e studentëve dhe protestat masive çuan në rrëzimin e bustit të diktatorit Hoxha nga qendra e Tiranës, një numër i madh relacionesh të ardhura nga strukturat e PPSH drejt Komitetit Qendror të PPSH shprehin midis të tjerash edhe zemërimin në rritje ndaj rolit të drejtuesve kryesorë, sidomos të Byrosë Politike dhe të ministrave. Për shembull, një relacion i Komitetit të Partisë së rrethit Tiranë, më 22 shkurt 1991, firmosur nga Sekretari i Parë, Rexhep Kolli, theksohet²⁰ *“alergjia e komunistëve dhe e njerëzve për Bllokun ka arritur në pikën më kulminante. Komunistë të ndryshëm e kanë thënë e po e thonë hapur se në rast të mos shpërbërjes shumë të shpejtë të Bllokut do të grumbullohen ata dhe me tesorat e ngritura lart do të kërkojnë heqjen e tij. Shumë prej tyre atë çka ndodhur me Enver*

¹⁸ Luljeta Progni, *Trashëgimtarët. Partia Socialiste midis transformimeve dhe vazhdimësisë*, Tiranë: UET Press, 2010, f. 103.

¹⁹ Intervistë e Fatos Veliut me Niko Gjyzarin, në *Gazeta Standard*, nr. 1944, datë 26.06.2011, f. 18-19.

²⁰ *AQSH*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 1, fl. 2 dhe 3. Relacion i KP të Tiranës, nr. 61, datë 22.02.1991.

Hoxhën e lidhin drejtpërdrejt me Bllokun". Në një tjetër relacion, nga KP Durrës, më 11 shkurt 1991 firmosur nga Sekretari i KP, Nazim Skuqi thuhet²¹ se baza ka vërejtje për mënyrën sesi merren vendimet dhe sesi janë bërë edhe ndryshimet në Byronë Politike dhe kërkojnë sqarime prej këtyre të fundit mbi gabimet që janë bërë.

Në mars në mbledhjen e Byrosë u diskutuan edhe për tri tërheqjet nga postet drejtuese. Anëtarët e Byrosë Besnik Bekteshi dhe Pali Miska kërkuan të mos kandidojnë më në zgjedhje dhe të tërhiqen nga postet politike në të gjitha nivelet e shtetit dhe të partisë, por kërkuan një trajtim të veçantë financiar²². Miska në kërkesën për dorëheqje thotë midis të tjerash se *"mendoj se nuk shkon më. Edhe ai pak autoritet që na ka mbetur ta ruajmë sesa ta prishim fare"*. Po ashtu, Hekuran Isai kërkoj largimin duke mbushur moshën e pensionit duke deklaruar midis të tjerash se duhej të largohej, pasi *"nuk kam çfarë të bëj këtu"*. Ky i fundit konfirmoi se gjendja *"është tronditëse, por e vërtetë: Një pjesë e madhe e drejtuesve të Partisë në rrethe, të trembur nga situata, kërkojnë të ikin"*. Në vijim të mbledhjes me vendim nr. 15, datë 9.4.1991 Sekretariati i KQ të PPSH trajtoi problemin e pajisjeve dhe të shpenzimeve në familje të anëtarëve dhe të kandidatëve të Byrosë Politike dhe të sekretariatit të Komitetit Qendror. Sipas vendimit²³, familjet e anëtarëve të Byrosë Politike mund t'i mbajnë pajisjet e banesave të tyre të dhëna falas nga shteti kundrejt një pagese simbolike që reflekton amortizimin e tyre. Në pikën e dytë të vendimit thuhet se fondi i PPSH do të përballojë abonimet në shtyp dhe bisedat telefonike në familje të anëtarëve të Byrosë Politike. Gjithashtu nga fondi partiak të mbulohen edhe shpenzimet që bëhen nga *"takimet ditore të sekretarëve të KQ dhe shokëve të tjerë të Byrosë"*.

Byroja Politike dhe përfaqësimi i saj në qeveri deri në maj 1991

Pas ngjarjeve të ambasadave në korrik 1990, PPSH bëri disa ndryshime në Byronë Politike duke larguar nga radhët e saj Manush Myftiun, Prokop Murrën dhe Rita Markon, dhe zëvendësuar ata me

²¹ *Po aty*, fl. 2. Informacion nr. 63 i KP Durrës drejtuar KQ të PPSH, 12.02.1991.

²² *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 2, fl. 39. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 06.03.1991.

²³ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh. V. 1991, D. 2, fl. 1. Vendim nr. 15, datë 09.04.1991.

Xhelil Gjonin, Vangjel Çërravën dhe Kiço Mustaqin, - ky i fundit ministër i Mbrojtjes Popullore deri në maj 1991. Në korrik, gjithashtu u ngritën në pozitën e kandidatit për anëtarë në Byro Politike, Niko Gjyzari dhe Xhemal Dymylja, ky i fundit drejtuesi kryesor i PPSH në rrethin e Shkodrës. Në mbledhjen e 11 dhjetorit 1990 u bënë ndryshime të reja në Byronë Politike. Sipas vendimit zyrtar²⁴ Plenumi “*liron nga funksionet anëtarët e Byrosë Politike shokët Muho Asllani, Simon Stefani, Lenka Çuko, Foto Çami, Hajredin Çeliku dhe shokët Qirjako Mihali dhe Pirro Kondi nga detyra e kandidatit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH*”. Pra, brenda pesë muajsh të vitit 1990 ishin larguar nga Byroja Politike, 8 anëtarë të Byrosë dhe dy kandidatë për anëtarë, ose mbi 66% e Byrosë.

Në shkurt - prill 1991, periudhë në të cilën ende Byroja Politike vijoi të jetë aktive dhe me takime periodike, anëtarë të rregullt të saj ishin Ramiz Alia, Adil Çarçani, Besnik Bekteshi, Xhelil Gjoni, Kiço Mustaqi, Hekuran Isai, Pali Miska, Vangjel Çërrava, Llambi Gegprifti, Xhemal Dymylja dhe Niko Gjyzari, kurse sekretarë të rinj të KQ, Spiro Dede dhe Abdyl Backa. Nga analiza e përbërjes së Byrosë në pluralizëm dhe në fushatën e parë elektorale pluraliste rezulton se më shumë se dy prej tyre ishin anëtarë prej vitit 1966, dy prej vitit 1976 dhe të tjerët të emëruar në vitet pasuese, pra me një karrierë shumë të gjatë drejtimi gjatë sistemit komunist.

Aktivi Kombëtar i PPSH, më 26 dhjetor 1990 krijoi Komisionin për Hartimin e Programit Politik të PPSH. Në Komision përveç anëtarëve të Byrosë, Ramiz Alia (Sekretar i Parë) dhe Adil Çarçani (kryeministër), u përfshinë edhe anëtarët ose ish anëtarët e tjerë të Byrosë, Besnik Bekteshi, Hekuran Isai, Kiço Mustaqi dhe Vangjel Çërrava, kurse në Komisionin për reformimin statusor u përfshinë anëtarët e Byrosë, Xhelil Gjoni (kryetar), Niko Gjyzari, Pali Miska dhe Xhemal Dymylja. Disa prej tyre vijuan të ishin pjesë drejtuese e grupeve të punës në parti, deri në zgjedhjen e komisionit organizativ të Kongresit, në mars 1991.

Një aspekt tjetër që tërheq vëmendjen është edhe raporti i vetë Byrosë me përbërjen e Këshillit të Ministrave dhe parlamentin e vitit 1991. Kështu, kur më 28 dhjetor 1990, Byroja Politike, nën ndikimin e presionit politik në vend, vendosi të bëjë disa ndryshime edhe në

²⁴ “Komunikatë mbi mbledhjen e Plenumit të KQ të PPSH”, në “*Zëri i Popullit*”, 12 dhjetor 1990.

Këshillin e Ministrave, nga anëtarët e Byrosë vijuan të mbajnë poste ministrore Adil Çarçani, Pali Miska, Hekuran Isai, Kiço Mustaqi dhe Besnik Bekteshi²⁵, kurse kur qeveria ndryshoi përsëri në shkurt 1991 dhe u krijua kabineti Nano, nga anëtarët e Byrosë vijoi të mbeten në qeveri ministri i Mbrojtjes, Kiço Mustaqi²⁶, kurse anëtari tjetër, Niko Gjyzari u bë guvernator i Bankës. Kabineti i krijuar pas zgjedhjeve parlamentare më 8 maj 1991, me kryeministër Fatos Nanon, ishte i pari kabinet në periudhën 1944-1991 që nuk kishte në të asnjë anëtar të Byrosë Politike.

Përfaqësimi i Byrosë në parlament ishte më jetëgjatë sesa në qeveri. Në fundin e muajit shkurt dhe në fillim të muajit mars 1991, kur PPSH zyrtarisht prezantoi listën përfundimtare të kandidatëve për deputetë, lista e re pati dallime të shumta nga ajo e miratuar nga Byroja Politike më 30 dhjetor. Në listën e re të kandidatëve mbetën vetëm Ramiz Alia, Xhelil Gjoni, Adil Çarçani, Kiço Mustaqi, Vangjel Çërrava, nga anëtarët apo kandidatët e Byrosë Politike, nga të cilët tre fituan dhe dy humbën përballë kandidatëve të opozitës. Disa prej anëtarëve të tjerë të Byrosë dhanë dorëheqjen nga kandidimi në zgjedhje në pamundësi për t'u përshtatur me realitetin e ri konkurrues politik, disa të tjerë u larguan nga vetë Alia dhe PPSH për shkak të imazhit negativ publik. Përfundimisht, në parlamentin e parë pluralist morën mandat deputeti anëtarët e Byrosë, Çarçani, Mustaqi dhe Gjoni, kurse Ramiz Alia, megjithëse humbi në zonën elektorale u zgjodh Presidenti i parë i Republikës në sistemin e ri politik. Nga tre anëtarët, vetëm dy përfunduan mandatin njëvjeçar, kurse i treti në dhjetor 1991 u arrestua nga organet e drejtësisë. Duhet theksuar se mbledhja e parë e parlamentit të parë pluralist shqiptar të vitit 1991 u hap pikërisht nga një anëtar i vjetër i Byrosë Politike, Adil Çarçani, për shkak të kriterit të moshës.

Nga shkurti 1991, me krijimin e Këshillit Presidencial me kompetenca të mëdha ekzekutive dhe kontrolluese mbi institucionet e tjera shtetërore, Ramiz Alia pranoi dobësimin e autoritetit dhe rolit të Byrosë Politike. Në Këshill nuk u zgjodhën asnjë prej anëtarëve apo kandidatëve të Byrosë dhe vetë mbledhjet e Këshillit zëvendësuan në përmbajtje funksionin udhëheqës dhe kontrollues të Byrosë. Vetë Alia konfirmoi në mbledhjen e Byrosë Politike në mars 1991 se “*nuk kemi*

²⁵ Dekret nr. 7462, datë 31.12.1991, “Për disa ndryshime në përbërjen e Këshillit të Ministrave”, në *Fletore Zyrtare* 1, Tiranë: 1991.

²⁶ Dekret nr. 7469, datë 23.02.1991, “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”, në *Fletore Zyrtare* nr.2, Tiranë: 1991.

organizma pushteti të mbështetura me ligj. Qeveria dhe Presidenca që krijuam deri në zgjedhje, në fakt po veprojnë, por mbështetje me ligj nuk kanë”, praktikë që vijoi edhe me Byronë Politike. Për të siguruar bashkërendimin e dy institucioneve dhe kontrollin e plotë politik mbi procesin, në njërin prej mbledhjeve të radhës Alia mblodhi së bashku për konsultime, Byronë, Këshillin Presidencial dhe Presidiumin e Kuvendit Popullor, kurse në një tjetër mbledhje në mesin e muajit mars 1991, ai ftoi në mbledhjen e Byrosë edhe disa ekspertë të ngarkuar për të hartuar platformën e re të organizimit të PPSH në kushtet e reja të pluralizmit politik. Qëllimi në çdo rast ishte i njëjtë, - zgjerimi i pjesëmarrjes në vendimmarrje në mënyrë që të zëvendësohej roli i Byrosë Politike dhe që gjenerata e re në PPSH të kishte më shumë hapësirë për të shprehur pakënaqësitë e tyre të njohura ndaj Byrosë Politike.

Gjatë muajve mars-prill 1991, Ramiz Alia ishte i interesuar të krijonte një ekip të ri brenda PPSH dhe që në Kongresin e qershorit 1991 të kryhej reformimi i partisë përmes një programi dhe ekipi të ri. Në funksion të këtij qëllimi ai bëri disa përpjekje për afrimin në PPSH të disa figurave të reja publike njëherësh mbështetës të tij. Të tillë ishin emrat e Spiro Dedes, Abdyl Backës, Ismail Lleshit, Servet Pëllumbit, figura të tjera, me të cilat PPSH organizoi fushatën elektorale të marsit 1991 dhe atë zgjedhore në prag të Kongresit, apo figura të tjera si Fatos Nano, Moikom Zeqo, Ylli Bufi, Shkëlqim Cani etj., të cilat megjithëse bënë pjesë në prurjet e reja në qeverinë e dhjetorit 1990, ishin piketuar për të qenë pjesë e stafit të ri të PPSH pas Kongresit. Në funksion të organizimit dhe reformimit të PPSH, Byroja Politike miratoi më 6 mars 1991 ngritjen e një Komiteti Organizator “*me një numër të madh rreth 70-75 veta dhe të ngarkohej me përgatitjen e Kongresit të 10-të të Partisë*”. Një mbledhje e Byrosë Politike më 13 prill 1991 vendosi midis të tjerash, të hartohej një program i ri dhe të krijohet një parti tjetër²⁷. Kongresi u mbajt më 10-13 qershor 1991. Në ditën e tretë të tij u mbajt një seancë e mbyllur, në të cilën u trajtua çështja e Byrosë Politike, privilegjeve, gabimeve e përgjegjësisive të saj, si dhe u vendos përjashtimi i tyre nga partia. Seanca më shumë i ngjau një gjyqi politik sesa një analize politike. Siç rezulton nga dëshmitë e protagonistëve të këtyre ngjarjeve, anëtarët e Byrosë Politike ishin të përgatitur se në një prej

²⁷ L. Progni, *Trashëgimtarët. Partia Socialiste midis transformimeve ...*, f. 82.

seancave të Kongresit do të dëgjonin kritika të ashpra ndaj figurës së udhëheqësit të tyre, prej të cilit kërkonin ende shpëtim²⁸.

Gjatë punimeve të Kongresit u përvijuan dy vija, grupi reformator kritik ndaj Hoxhës dhe trashëgimisë së tij dhe grupi konservator, mbështetës ndaj tij. Disa nga delegatët, sidomos ata të Fierit, sulmuan ashpër Byronë Politike si “*shkaktar të degradimit të partisë së tyre*”²⁹. Ata adresuan katër akuza konkrete, - politikën e dështuar të partisë që çoi në krizën ekonomike e sociale, shkëputjen e tyre nga masa e anëtarëve të thjeshtë dhe nga populli, privilegjet dhe korrupsionin e tyre gjatë qëndrimit në udhëheqjen e lartë të partisë si dhe braktisja prej tyre e partisë në çastet e vështira të jetës së saj, veçanërisht gjatë fushatës elektorale³⁰. Një nga organizatorët kryesorë të këtij debati, ish Sekretari i KQ të PPSH, Spiro Dede i kritikoi katër akuzat, pasi sipas tij, “*ata nuk kritikuan Byronë për dështimet e sistemit dhe se nuk kishin realizuar ndryshimet në sistem dhe në ekonomi, por vetëm pse nuk kishin ditur të qeverisin, pra që qëndronin në pushtet*”³¹. Ndaj akuzave anëtarët e Byrosë nuk arritën të gjejnë argumente dhe në përfundim, anëtarët e Byrosë u përjashtuan nga partia me votim të hapur, duke veçuar nga kjo listë vetëm emrat e Ramiz Alisë dhe Xhelil Gjonit.

Byroja Politike si organ drejtuese *de facto* i shtetit pluralist

Dispozitat Kryesore Kushtetuese, neni 24, përcaktonin se “*Presidenti i Republikës së Shqipërisë është kryetari i shtetit dhe përfaqëson mbarë unitetin e popullit*” dhe sipas nenit 26, “*funksioni i Presidentit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër, veç atyre të parashikuara me këtë ligj*”³². Sipas këtyre përcaktimeve, Presidenti nuk mund të ishte as anëtar e aktivist në partitë politike dhe as mbështetës i një partie politike në ushtrimin e funksioneve të tij. DKK u miratuan më 29 prill 1991 dhe një ditë më pas, Ramiz Alia bëri betimin si President i parë i sistemit të ri politik. Disa ditë më vonë, më 4 maj 1991, Sekretari i Parë i PPSH dhe Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor Ramiz Alia i adreson një

²⁸ *Po aty*.

²⁹ *Po aty*, f. 85.

³⁰ “Byroja Politike përpara gjyqit”, në “*Zëri i Popullit*”, 12.06.1991.

³¹ L. Progni, *Trashëgimtarët. Partia Socialiste midis transformimeve ...*, f. 86.

³² Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, në *Fletore Zyrtare* nr. 6, Tiranë: 1991.

letër strukturave të bazës së PPSH dhe anëtarëve të saj. Letra nuk është bërë publike, por gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit.

Letra është lamtumira e tij nga anëtarësia në PPSH dhe kalim sipas Kushtetutës, në pozicionin e kryetarit të shtetit mbi palët politike. Megjithatë letra është komunikimi i fundit zyrtar i Alisë me strukturat e PPSH dhe si i tillë ka edhe vlerë të veçantë. Në letër, Alia thotë se zgjedhja e tij President “*nuk duhet të ketë rënie në punët e partisë, përkundrazi ... anëtarët duhet ta kuptojnë se kjo (largimi nga PPSH, shënimi im), “është në të mirë të Partisë sepse në kushtet e pluralizmit, kur veprimtaria shtetërore del në plan të parë, zgjedhja në krye të shtetit e një përfaqësuesi të Partisë është nder për të”*. Ai i bën apologji pafund PPSH dhe rolit të saj historik, duke theksuar se “*Partia jonë e themeluar nga Enver Hoxha, në 50 vjet të jetës së saj e ka udhëhequr vendin drejt arritjesh të pakontestueshme. Me partinë Shqipëria arriti fitoren e lirisë dhe të pavarësisë së saj. Me LANÇ të udhëhequr nga PPSH u hap rruga e krijimit të Shqipërisë së re dhe e transformimeve themelore në të gjitha fushat kryesore të jetës. Prandaj komunistët shqiptarë nuk kanë pse ta ulin kokën*”³³. Në përfundim të letrës Alia betohet se “*me shpirt, me zemër, me mendje gjithmonë jam e mbetem luftëtar i vendosur i Partisë tonë të dashur. Rroftë Partia e Punës*”. Në të njëjtën ditë, më 4 maj, Alia drejtoi edhe një mbledhje të Komitetit Qendror të PPSH. Sipas procesverbalit të mbledhjes, i cili ndodhet në Arkivin e Shtetit, Alia kërkoi në mbledhje që të lirohet nga funksioni i anëtarit të Byrosë Politike dhe funksionet e tjera të larta në parti, për shkak të zgjedhjes së tij si President.

Si rezulton edhe nga dokumentet dhe rastet e mësipërme, krahas mbledhjeve të rregullta të zhvilluara nga Byroja Politike edhe në kushtet e pluralizmit politik, ajo vijoi të ushtronte edhe përgjegjësi të tjera që nuk lidhen me statusin e një forumi të një partie politike, por me strukturën drejtuese të vetë shtetit. Alibia sipas të cilës, Byroja ishte një strukturë e PPSH dhe përderisa PPSH ekzistonte edhe në pluralizëm ishte e drejta e saj të kishte Byro dhe mbledhje të saj, bie në ballafaqimin me një numër të madh dokumentesh që provojnë vendimmarrje që nuk i përkasin strukturës së një partie, por funksionit udhëheqës shtetëror ashtu si gjatë periudhës së sistemit njëpartiak.

³³ AQSH, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 2, fl. 4. Letër e R. Alisë drejtuar organizatave bazë dhe anëtarëve të PPSH, 04.05.1991.

Konkretisht, më 30 janar 1991, Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ vendosën që *“sektori për organet e pushtetit, të punëve të brendshme dhe të drejtësisë në aparatit e KQ të PPSH, dhe aktiviteti i sektorit të kuadrit për këto organe dhe të ushtrisë, të transferohen nga ky aparat në Këshillin e Ministrave të RPSSH³⁴”*. Vendimi parashikonte gjithashtu se punonjësit dhe strukturat do të ishin të njëjta, por pjesë e organikës së qeverisë. Sipas legjislacionit në fuqi më 1991, kjo kompetencë e kalimit të personelit dhe emërimit në Këshillin e Ministrave ishte vetëm e Presidiumit të Kuvendit Popullor apo e drejtë për inicim procesi, nga e para, e vetë Këshillit të Ministrave, por jo kompetencë dhe e drejtë e Byrosë Politike apo e një subjekti politik në pluralizëm, siç ishte PPSH.

Gjatë janarit 1991, Byroja Politike mori vendim për ndryshime në nomenklaturën e emërimeve të kuadrove, për shkrirjen e Komiteteve të Partisë dhe strukturave partiake në organet e punëve të brendshme në ushtri dhe në organet e tjera, të cilat në kushtet e pluralizmit duhej të ishin të depolitizuara, për mbylljen e Shkollës së partisë dhe krijimin e qendrës kulturore të PPSH, për ndryshime në organizimin e partisë, për ndryshime në buxhetin e shtetit, për emërime dhe transferime zyrtarësh në nivele të ndryshme ekzekutive etj. Shumica e këtyre vendimeve datojnë më 31 janar 1991, kohë kur në kushtet e pluralizmit politik, organet me kompetenca vendimmarrëse të tyre ishin kryesisht Këshilli i Ministrave, Kuvendi Popullor etj. Për shembull, vendimi nr. 4 i Byrosë Politike, datë 31.01.1991 përcaktonte se *“të gjithë kuadrot e organeve shtetërore dhe ekonomike, të arsimit e të kulturës, të ushtrisë dhe të organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në rrethe e në njësitë ushtarake dhe në dikastere e në institucionet qendrore, që deri tani emërohen e miratohen nga Byroja Politike, Sekretariati dhe Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, të kalojnë në kompetencë të Këshillit të Ministrave të RPSSH³⁵”*. Në vijim vendimi përcaktonte se nuk do të ishte më kompetencë e Byrosë dhe e KQ të PPSH përbërja e delegacioneve të Kuvendit Popullor dhe qeverisë që dërgohen jashtë shtetit, përbërja e delegacioneve qeveritare dhe të tjera që dërgohen jashtë, ftesat për delegacionet e huaja etj. Të dyja këto kompetenca ishin përgjegjësi dhe kompetenca kushtetuese të Kuvendit Popullor dhe në mungesë të tij, e

³⁴ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 9, fl. 1. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH nr. 3, datë 30.01.1991, “Transferim sektori nga aparati i KQ të PPSH”.

³⁵ *Po aty*, F. 14/AP-org.ush., V. 1991, D. 4, fl. 1. Vendim nr. 4 i Byrosë Politike, datë 31.01.1991.

Presidiumit të Kuvendit Popullor. Pavarësisht nga kjo, vendimi i Byrosë iu adresohet në formë urdhri për zbatim të gjitha institucioneve, mban firmën dhe vulën e PPSH dhe ka vlerën e dokumentit zyrtar të organit superior. Konkretisht, në fund të vendimit, thuhet se *“për zbatimin e këtij vendimi, krahas Komiteteve të Partisë ngarkohen “Komitetet e divizioneve e të njësisve të një rangu me to dhe sektorët e kuadrit”*. Në Arkivin e Shtetit gjenden vendime dhe udhëzime urdhëruese të saj ndaj organeve të tjera shtetërore të muajve prill apo maj 1991. Konkretisht, në një relacion³⁶ adresuar Xh. Gjonit, sekretar në KQ të PPSH nga kryetarja e organizatës bazë të PPSH në Gjykatën e Lartë, Eleni Selenica, provohet se me gjithë ardhjen e pluralizmit politik, strukturat e partisë – shtet vijnë të jenë tërësisht funksionale. Sipas relacionit, më 6 shkurt 1991 është zhvilluar mbledhja e radhës e organizatës së PPSH në Gjykatën e Lartë me objekt kryesor debati *“për një mobilizim maksimal dhe disiplinë të lartë nga komunistët për të realizuar detyrat që shtron situata e sotme dhe për t’u bërë propagandistë të programit elektorale të PPSH”*. Po ashtu, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes nr. 12, datë 30.12.1990 u krijua Drejtoria Politike e Ushtrisë pranë Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Në vendim, pasi përcaktohen detyrat e kësaj drejtorie, midis të tjerash edhe për *“organizimin dhe zhvillimin e punës ideologjike me kuadrot e efektivat, të agjitacionit të propagandës”*, theksohet se *“drejtoria politike do të mbajë lidhje edhe me komitetet e Partisë të njësisve ushtarake për çështje partie”*³⁷. Shkresa përcjellëse drejtuar të gjitha repartëve ushtarake mban firmën e sekretarit të KQ, Xhelil Gjoni³⁸. Më 8 shkurt 1991, doli dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor³⁹ për të ngarkuar qeverinë të studiojë e hartojë projektligjet lidhur *“me vendin dhe rolin e ushtrisë, të organeve të punëve të brendshme e të drejtorisë në kushtet e pluralizmit politik”*. Projektet pasi të jenë diskutuar në ushtri, në organet e punëve të brendshme dhe ato të drejtorisë, duhej t’i paraqiteshin

³⁶ Po aty, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 9, fl. 1 Informacion i organizatës së PPSH në Gjykatën e Lartë drejtuar KQ të PPSH.

³⁷ Po aty, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 2, fl. 1. Vendim i Këshillit të Mbrojtjes nr. 12, datë 30.12.1990.

³⁸ Po aty, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 2, fl. 1. Njoftim i KQ të PPSH drejtuar komiteteve të partisë në repartet ushtarake, nr. 233, datë 30.01.1991.

³⁹ Po aty, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 2, fl.1. Vendim nr. 350, datë 08.02.1991, “Për masat që duhen marrë lidhur me përcaktimin e vendit dhe të rolit të ushtrisë, të organeve të punëve të brendshme dhe të drejtësisë në kushtet e pluralizmit politik”,

për shqyrtimin e miratim Kuvendit Popullor që do të dalë nga zgjedhjet e 31 marsit 1991.

Një provë tjetër se Byroja Politike vijonte të ishte organi kryesor vendimmarrës edhe në kushtet e pluralizmit politik është vendimi i Këshillit të Ministrave, më 16.12.1990. Në këtë vendim si bazë ligjore referimi merrej vendimi i Byrosë Politike i datës 20.03.1990 “*Kriteret për demokratizimin e mëtejshëm të procedurave në zgjedhjen dhe emërimin e kuadrove*”. Sipas njoftimit zyrtar, Këshilli i Ministrave vendosi t’i rekomandojë Byrosë Politike shfuqizimin e dy pikave të këtij vendimi⁴⁰. Vendimi i Byrosë për jetësimin e kësaj kërkesë mban numrin 10, datë 24.12.1990 dhe konsiderohet “sekret”, megjithëse thelbi i vendimit lidhet me ndryshimin e sistemit të emërimeve të kuadrove drejtuese në institucione përmes organeve të emërtesës. Më parë, me vendimin e marsit 1990, emërimi bëhej përmes “zgjedhjes” përmes kolektivave punonjësve, me votim të hapur ose të fshehtë dhe me një ose më shumë kandidatë. Për kuadrot e larta drejtuese kërkohej mendimi i organeve të larta të Partisë. Ndryshimi i vendimit në dhjetor 1990 lidhej me situatën e re politike, në të cilën Byroja Politike udhëzoi praktikën që sistemi i emërimit të rikthehej në drejtimin vertikal, sipas legjislacionit, duke evituar mbledhjet e hapura dhe debatet publike.

Me vendimin e datës 15 maj 1991, pra gjashtë muaj pas vendosjes së pluralizmit politik në Shqipëri, Byroja Politike vendos “*shkrirjen e Komiteteve, Byrove dhe organeve bazë të partisë në njësitë ushtarake, në organet e punëve të brendshme, të drejtësisë dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme*”⁴¹ etj. Në funksion të vendimit, KQ miratoi një udhëzim të detyrueshëm për institucionet, mbi mënyrën e kalimit të dosjeve të anëtarëve të PPSH nga institucioni në Komitetin Qendror të PPSH. Konkretisht, sipas udhëzimit, “*anëtarët e partisë në këto institucione duhet të dorëzonin tesarat e partisë, kurse dosjet personale të anëtarëve të partisë do të dorëzoheshin të plota në strukturat e PPSH. Dosjet e anëtarëve në varësi të KQ, ato të MPB, të MPJ, të drejtësisë, të ushtrisë, etj., do të dorëzoheshin të plota në kartotekën e KQ të PPSH. Dosjet e divizioneve të rretheve do të dorëzoheshin në kartotekat e PPSH në*

⁴⁰ Vendim nr. 2357, datë 16.12.1990, i Këshillit të Ministrave, në *Fletore Zyrtare*, nr. 6, Tiranë: 1990.

⁴¹ *AQSH*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 2, fl. 1. Byroja Politike e KQ. Vendim nr.21, datë 15.05.1991, “Për shkrirjen e komiteteve, byrove, organizatave të partisë në ushtri, në organet e punëve të brendshme, në drejtësi dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme”.

rrethet përkatëse, dosjet e kandidatëve për anëtarë nga ushtarët gjithashtu do të depozitoheshin në kartotekat e KQ të PPSH⁴², etj. Në pikën 6 të Udhëzimit thuhet se “anëtarët e partisë që dërgohen me punë në përfaqësitë tona jashtë shtetit, për studime apo për specializime, si vizitorë ose kur punësohen sipas ligjeve jashtë vendit, dorëzojnë dokumentin e partisë në Komitetin e Partisë të rrethit ku janë efektivë. Me t’u kthyer në atdhe ata e rimarrin dokumentin⁴³”, një praktikë tipike për periudhën e sistemit njëpartiak dhe pa mbështetje ligjore në sistemin shumëpartiak.

Paradoksi më i madh i dokumentit gjendet në pikën 4 të vendimit të Byrosë, në të cilin për zbatimin e tij “ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e këtyre udhëzimeve Komitetet e Partisë të rretheve, Komitetet e Partisë të Divizioneve e njërive të tjera ushtarake, Komiteti i Partisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe aparati i Komitetit Qendror të PPSH⁴⁴. Pra, shkresa ngarkon me përgjegjësi dhe është urdhëruese për Ministrinë e Brendshme, për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura etj., organe të cilat me Dispozitat Kryesore Kushtetuese nuk duhet të kishin lidhje dhe as ndërvarësi politike.

Me vendim të Byrosë, më 25 maj 1991, i fundit vendim i rëndësishëm i saj, ajo urdhëroi shkrirjen e Komiteteve, Byrove dhe strukturave të tjera partiake në organet e Punëve të Brendshme e të Jashtme, një referim për Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Jashtme. Vendimi kishte gjithashtu përmbajtje detyruese, ndërkohë që kompetenca për një akt të tillë ndaj ministrive ishte vetëm e Kuvendit të ri Pluralist, Presidentit dhe Këshillit të Ministrave. Në Arkiv gjenden edhe akte nominale emërimi të Byrosë dhe të Komitetit Qendror në administratën shtetërore, praktikë e cila vinte ndesh me Kushtetutën e re dhe me ligjin. Për shembull, me vendimin e firmosur nga Xh. Gjoni në emër të Byrosë dhe KQ bëhet emërimi i një individi si specialist në

⁴² *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 6, fl. 1. Udhëzim i KQ nr. 26, datë 22.05.1991, “Për zbatimin e vendimit të Byrosë Politike nr.23, datë 15.05.1991”.

⁴³ *Po aty*, fl. 4 dhe 5. Udhëzim i KQ nr. 26, datë 22.05.1991, “Për zbatimin e vendimit të Byrosë Politike nr. 23, datë 15.05.1991”.

⁴⁴ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 6, fl. 2. Vendim nr.21 i Byrosë Politike të KQ, datë 15.05.1991, “Për shkrirjen e komiteteve, byrove, organizatave të partisë në ushtri, në organet e punëve të brendshme, në drejtësi dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme”.

Ministrinë e Transporteve⁴⁵. Shkresa nuk është kërkesë dhe as sugjerim, por vendim i njëjtë në formë e përmbajtje me aktet e ngjashme të Byrosë dhe KQ përpara dhjetorit të vitit 1990, një kompetencë që në pluralizëm e kishte vetëm ministria.

Në një tjetër vendim të saj në mesin e muajit maj 1991, Byroja Politike vendosi të mbyllet Shkolla e Partisë dhe të organizohet në vend të saj Qendra Kulturore e PPSH me funksion *“të shërbejë për kualifikimin ideoteorik të kuadrove dhe të militantëve të Partisë në kushtet e reja, të zhvillojë veprimtari të përditshme gjithëvjetoare për problemet kulturore, edukative, çlodhëse me komunistët, por edhe me qytetarët e me rininë e Tiranës, të shërbejë si qendër metodike për klubet e Partisë në rrethe”*⁴⁶. Pavarësisht se Shkolla e Partisë kishte qenë për vite me radhë një strukturë ideologjike brenda PPSH, në maj 1991 ajo ende ishte një prej zërave të veçantë, përfitues nga Buxheti i Shtetit dhe jo nga buxheti vjetor i PPSH. Në vendimin e cituar, Byroja Politike vendos edhe rregulla ekonomike, madje përcakton edhe pronësi mbi objektet dhe hapësirat e shkollës e rreth saj, kompetenca që në maj 1991 ishin vetëm të Këshillit të Ministrave ose të Kuvendit Popullor. Konkretisht, në vijim vendimi thekson se në funksion të Qendrës do të ishin ndërtesa e Shkollës së Partisë, ndërtesat ngjitur me të, menca dhe lavaxeria. Byroja udhëzoi që *“ndërtesat e tjera rreth shkollës të kalojnë për përdorim për ekonomi private”*, dhe të ardhurat t’i kalojnë Qendrës. Sipas strukturës së përcaktuar nga Byroja, Qendra do të kishte një personel prej 10 pedagogësh dhe një staf administrativ mbështetës. Më tej, vendimi përcakton edhe se mjediset dhe lokalet e degëve të PPSH në rrethe që janë përdorur për kurse kualifikimi, *“të përdoren si qendra çlodhëse dhe edukimi duke siguruar prej tyre të ardhura financiare”*⁴⁷. Në një relacion të S. Dede, Sekretar i KQ të PPSH më 11 mars 1991, instruktosheshin Komitetet e Partisë në rrethe që studentët që vazhdojnë Shkollën e Lartë të Partisë V.I.Lenin nga secili rreth të paraqiten në KP për praktikant mësimorë. Praktikant do kenë objekt *“zbërthimi i programit*

⁴⁵ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 3, fl. 1. Vendim nr.14, datë 09.04.1991, “Lëvizje kuadri”.

⁴⁶ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 6, fl. 1. Vendim nr. 23 i Byrosë Politike të KQ të PPSH, datë 15.05.1991, “Për shkollën e partisë”.

⁴⁷ *Po aty*, fl. 2.

*elektoral të PPSH dhe propaganda për të siguruar fitoren në zgjedhjet e 31 marsit të kandidatëve të PPSH-së*⁴⁸”.

Gjithashtu, përmes udhëzimit të Byrosë Politike, Komiteti Qendror vendosi në prill 1991⁴⁹ që “*organet e shtypit lokal duhet të marrin një fizionomi tjetër duke pasqyruar realitetet e reja*”. Në terma konkretë, u sugjerua që shumica e gazetave lokale të Komiteteve të Partisë të riorganizohen, të ndryshojnë strukturë dhe të shpallen si organe të pavarura. Siç theksohet në udhëzim, “*gazetat e reja do të jenë nën ndikimin e Partisë së Punës, përmes programit që ajo i ka ofruar popullit, përmes interesave të saj që janë në të mirë të popullit, përmes gazetarëve të cilët punojnë në këto redaksi*”⁵⁰. Vendimi nuk është vetëm në njëpartiake (gazetat e partisë), por lidhet edhe me mjediset e punës, redaksitë, administratën, sistemin e shpërndarjes, furnizimin me lëndë të parë dhe energji etj., shpenzime, të cilat më 1991 mbuloheshin nga buxheti i shtetit.

Një tregues tjetër i sjelljes së PPSH si parti e njësuar me shtetin është edhe faktori se ajo vijoi edhe në më shumë se 6 muajt e parë të pluralizmit politik të kishte në përdorim të njëjtat godina, të cilat ishin edhe godina qendrore në Tiranë dhe në qytetet e tjera të vendit. Konkretisht, ekipi drejtues i PPSH vijoi të ushtronte aktivitetin e vet në godinën e sotme të Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, praktikë që u ruajt edhe pas shpalljes së pluralizmit, madje edhe pas ndryshimit të emrit të PPSH, në qershor 1991, në PSSH. Sipas të dhënave zyrtare, më 2 prill 1991⁵¹ centrali i Komitetit Qendror kishte 600 numra telefonikë, nga të cilët 204 për aparatin e KQ, 85 për Presidiumin e Kuvendit Popullor, 90 Këshilli i Ministrave, 45 Komisioni i Planit të Shtetit, 40 Ministria e Punëve të Jashtme, 35 Bashkimet Profesionale, 20 Bashkimi i Rinisë, 15 Bashkimi i Grave, 5 Fronti Demokratik, 30 Komiteti i Partisë në Tiranë dhe 30 numra Pallati i Kongreseve. Të gjitha shpenzimet mbuloheshin

⁴⁸ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 9, fl. 1. Udhëzim i KQ drejtuar KP në rrethe, nr. 547, datë 11.03.1991.

⁴⁹ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 9, fl. 1. Udhëzim nr. 815, i KQ të PPSH adresuar Komiteteve të PPSH në rrethe dhe gazetave lokale, 18.04.1991.

⁵⁰ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 6, fl. 1-2. Vendim nr. 14, datë 18.04.1991, drejtuar komiteteve të partisë në rrethe.

⁵¹ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 9, fl. 16. Vendim nr. 13 i Sekretariatit të KQ të PPSH, datë 02.04.1991, “Për kalimin e centralit telefonik automatik në varësi të aparatit të Këshillit të Ministrave”.

nga fondi i PPSH dhe koordinimi e mirëmbajtja e tyre, pavarësisht se janë institucione me natyrë të ndryshme në një sistem demokratik, ishin gjithashtu përgjegjësi e aparatit të PPSH-së.

Pjesë e të njëjtës logjikë ishte edhe zëri më vete i buxhetit shtetëror vjetor për PPSH dhe Komitetin Qendror, pavarësisht se me vendosjen e pluralizmit politik buxheti do të duhej të përshtatej me realitetet e reja dhe të kthehej në buxhet shtetëror vjetor për partitë politike. Buxheti i parashikuar nga shteti vetëm për Kongresin X të PPSH ishte 1 824 383 milionë lekë, nga të cilët 21 071 milionë ishin për dhurata ndaj të huajve, raporti i Kongresit i shumëfishuar rreth 30 192 milionë⁵². Në mars 1991, me vendim të Sekretariatit të KQ, Ramiz Alia urdhëroi nga Fondi i Solidaritetit dhënien e 40 mijë dollarëve për udhëtime dhe dieta për “delegacionet dhe miqtë e ftuar nga PPSH”, 5 mijë dollarë për “*nevoja të partive dhe miqve të huaj që mbajnë lidhje me PPSH, dhe 5 mijë dollar të tjerë për “veprimtaritë propagandistike që lidhen me partinë dhe miqtë e huaj”*”⁵³. Me një tjetër vendim, më 11 prill 1991, iu akorduan 10 mijë dollarë “*mikut neozelandez Ron Tejlor*”, me motivimin “*për shpenzimet e udhëtimit dhe të sistemit në Zelandën e Re*”⁵⁴.

Përfundime

Historia e Byrosë Politike në periudhën pluraliste është një prej treguesve më domethënës të paradokseve që shoqëruan fillimet e tranzicionit nga sistemi njëpartiak në atë shumëpartiak e demokratik në Shqipëri. Ndryshimi i akteve kushtetuese dhe ligjore nuk u shoqërua me ndryshim të sjelljes politike në raportet midis partisë dhe shtetit. Në dhjetor 1990 u miratua pluralizmi, në mars 1991 u bënë zgjedhjet e para pluraliste, në prill 1991 u shfuqizua Kushtetuta e periudhës komuniste dhe u miratua Paketa Kushtetues e re e njohur si Dispozitat Kryesore Kushtetuese, duke shënuar edhe në nivel kushtetues kalimin në sistemin e ri politik. Megjithatë midis realitetit kushtetues dhe mentalitetit të drejtimit nga Byroja Politike kishte ende një hendek të madh.

⁵² *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 2, fl. 3. Raportim nr. 12 në Byronë Politike të KQ të PPSH mbi buxhetin e shtetit 1991.

⁵³ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 9, fl. 1. Vendim nr. 7 i Sekretariatit të KQ, datë 15.03.1991, “Për përdorimin e fondit të solidaritetit për vitin 1991”.

⁵⁴ *Po aty*, F. 14/AP-org.udh., V. 1991, D. 9, fl. 1. Vendim nr. 16 i Sekretariatit të KQ të PPSH, datë 11.04.1991.

Byroja Politike, siç tregohet edhe nga shembuj të shumtë të cituar në këtë punim, vijoi të sillej jo si një organ i lartë politik i një partie, por si organ politik drejtues i shtetit, - një praktikë pune tradicionale e saj gjatë sistemit komunist. Praktika e vendimmarrjeve në emër të organeve të tjera të shtetit, sidomos të Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave, tipike për rolin e Byrosë Politike në një sistem njëpartiak, vijoi deri në qershor 1991. Ajo vijoi të imponojë drejtimin politik të institucioneve kushtetuese dhe atyre ekzekutive, të ketë kontroll mbi institucionet e sigurisë publike, të diplomacisë, të mbrojtjes etj., si dhe mori vendime të shumta detyruese për organet shtetërore e kushtetuese. Brenda pak muajsh organi më i pushtetshëm në vend u dëbua nga jeta politike kryesisht për shkak të presionit qytetar ndaj modelit, trashëgimisë, imazhit negativ dhe bilancit kritik që ajo përfaqësonte. Roli dhe bilanci i saj gjatë 6 muajve të pluralizmit politik ishin sinteza e kësaj trashëgimie dhe treguesi më i qartë i diferencës së madhe midis pritshmërive reformuese të vitit 1991 dhe konceptit të vazhdimësisë në kushtet e reja që aplikoi jo pa sukses elita drejtuese e regjimit në ikje.

S u m m a r y

THE POLITICAL BUREAU IN PLURALISM, ITS DECISIONS AND ACTIVITY FROM DECEMBER 1990 TO JUNE 1991

The political developments of 1991 in Albania were accompanied by sharp contrasts and coexistence of new concepts such as democracy with the remnants of the previous mono-party system. A typical example was the functioning of the Political Bureau as a party and state institution even under the system of political pluralism. This paper examines the political events from December 1990 to June 1991, a period during which the institution of the ALP's Political Bureau continued to function and take decisions despite the new reality of political pluralism.

Many studies and archival documents show that the Political Bureau continued to behave not like a high political organ of a party, but as a political institution leading the state, - a traditional practice throughout the communist system. Taking decisions on behalf of other state institutions, especially the People's Parliament and the Council of Ministers, was common occurrence for the Political Bureau under the mono-party system, and it continued to take place until June 1991. The Bureau kept imposing the way constitutional and

executive institutions were to be run politically, maintained control over the public safety, diplomatic and defense institutions, etc. and in addition, took several constraining verdicts for the state and the constitutional organs. The existence of the Bureau during the pluralist period and its decisions despite the establishment of a new political system were representative of the fragility of the democratic concepts but also of the predominant political culture of the time, according to which the new system was controlled by the old system and the political and state structures were an accessory of the latter. In the spring of 1991 the most powerful political and state institution of the country was forcefully dismissed from the political life mainly due to citizens' pressure who disapproved the model, heritage, negative image and outcome the Bureau represented.

This paper analyzes all the major decisions of the ALP's Political Bureau during the political pluralism, the curve of transition from a major decision making institution to its full disintegration, the acts which had an impact on the political and executive power, the status and the composition of the Bureau, the relations of other state institutions with it, and additional important elements in the phase of establishing new political entities and institutions in Albania, from January to June 1991. The funds of documents used were mainly obtained from the State Central Archives but also additional archival sources and memoirs were used.

Key words: Political Bureau, Albanian Labor Party (ALP), controlled pluralism, political culture, elections, transition.